



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18 Mars 2021

Nr: 159

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E Z. PLARENT XHORXHI ALEKSI SI KANDIDAT PËR DEPUTET I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT NË ZONËN ZGJEDHORE QARKU BERAT, NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 69 e 73, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga komiteti nismëtar, për regjistrimin e z. Plarent Xhorxhi Aleksi si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Berat për zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 38, datë 05.02.2021 ka regjistruar komitetin nismëtar i cili do të organizojë punën për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për paraqitjen e z. Plarent Xhorxhi Aleksi, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

Me shkresën nr. 1415 prot., datë 23.02.2021, komiteti nismëtar ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nënshkrimet mbështetëse të 1034 zgjedhësve, për të cilët shprehet se janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë në zonën zgjedhore, Qarku Berat.



Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, qarku Berat; Model – 04;
2. Deklaratën e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit se nuk është pjesë e asnjë partie apo koalicioni dhe se nuk do të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë, ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurren në zgjedhje, Model - 05;
3. Listat e zgjedhësve të zonës zgjedhore që mbështesin kandidatin të nënshkruar prej tyre sipas Modelit - 06, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit;
4. Jetëshkrimi i kandidatit Model – 07;
5. Formulari i vetëdeklarimit.

Referuar ekstraktit më të fundit të listës së zgjedhësve rezulton se Qarku Berat ka 184.340 (njëqind e tetëdhjetë e katërmijë e treqind e dyzet ) zgjedhës. Sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 69, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, numri i zgjedhësve që i korrespondon kufirit minimal prej 1 për qind të listës së 184.340 zgjedhësve të zonës zgjedhore, qarku Berat është 1.843 (njëmijë e tetëqind e dyzet e tre) zgjedhës.

KQZ, me shkresën nr.1529/1 prot., datë 04.03.2021 i ka kërkuar komitetit nismëtar dhe z. Plarent Xhorxhi Aleks i korrigjimin për plotësim të dokumentacionit sipas pikës 3 të nenit 69, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Brenda afatit komiteti nismëtar nuk ka depozituar dokumentacionin e korrigjuar.

Neni 69 pika 3 përcakton se komiteti mund të regjistrojë një kandidat për deputet vetëm në rast se ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por në çdo rast jo më shumë se 3000 (tre mijë) zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi për regjistrimin e z. Plarent Xhorxhi Aleks, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet në zonën zgjedhore, qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 69, 72 e 73 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.



## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 69, 71, 72 e 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

## V E N D O S :

1. Të refuzoj kërkesën për regjistrim të z. Plarent Xhorxhi Aleks, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

